- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontrates;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					



---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

---

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

**Afatet e lëvrimit:**

<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Destinacioni</b>	<b>Periudha e dorëzimit</b>

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ne DST;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8 ne DST*
- c. Formularin e Ofertes sipas Shtojcës 1 ne DST*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe nenit 29, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Të jete i regjistruar në Regjistrin Tregetar ne Republikën e Shqiperise

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. **Xhiroja vjetore minimale**-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018,2019,2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres se Fondit Limit.

---

**Argumentimi:** Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejmë te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar;*

Si dhe ne nenin 43 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", si dhe nenin 55 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ku percaktohet se *4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.*

Vendosja e ketyre kritereve behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 pika 4 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;*

si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave,

**2.2.2. Bilancet vjetore-**Operatorëtekonomikëduhettëparaqesinbilancet vjetore, për vitet financiare 2018,2019,2020,të paraqiturpraneAdministrates Tatimore tekonfirmuarngakyaautoritet dhe ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar

Vendosja e ketyre kritereve behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me



---

poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. **Deshmi per furnizime të ngjashme te meparshmenë** në një vlerëjo me tëvogël **20%** te vleres se fondit limit, për të cilin konkurron operatori ekonomik, qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates si me poshte :

- a) Autoriteti Kontraktorsidëshmi për përvojën e mëparshme kërkohet të lëshuar nga entitet publik, kontrata furnizim ose/ dhe faturat tatimore të shitjes, kushënohendatat, shumat ,sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, sidëshmi pranohet vetëm faturat tatimore të shitjes, kushënohendatat, shumatsasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin gjejme te percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4/b te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilin eshte e percaktuar se: [...]Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat ethjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se **40%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

---

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:  $40\% \times 3.000.000 = 1.200.000$  leke.

.Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

**2.3.2 Standartet e sigurimit të cilësisë** - Për autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si certifikata ISO ku operatori ekonomik duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatat:

- a) **ISO 9001:2015 - Çertifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;**

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit si dhe gjithashtu në mbështetje të nenit 40, pika 7/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

---

*Ky kriter kërkohet që OE është i certifikuar sipas standartit ndërkombëtare që produktet apo paisjet e sjella janë të garantuara në cilësi dhe nuk janë produkte të pakontrolluara apo të fallsifikuara.*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese Certifikaten e Konformitetit CE, për plotësimin e standartit Shqiptar SSH IEC 60898-1:2015AL:2019 ose ekuivalenten të dhe standartin Shqiptar SSH EN 60947-2:2017 ose ekuivalente për automatet termo elektronike- magnetike

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79 pik1, të Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Ky kriter kërkohet për të siguruar lidhur me cilësinë e mallrave.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese: Autorizimin e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar e materialeve elektrike. *Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këtë kriter është në përputhje me nenin 44, pika 5 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79, të Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqese:

Autorizimin e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar e materialeve elektrike. *Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetoj këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar.*

**Argumentimi :** Kriteri i mësipërm vendoset në mbështetje të pikës 8 të nenit 40 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti

---

*kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Ky kriter është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës Blerje materiale elektrike etj si dhe në përputhje me dispozitën e sipërcituar. Autoriteti kontraktor, Bashkia selenice nëpërmjet këtij kriteri kërkon të garantohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në lidhje me origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht kërkon nga ofertuesit që të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar prej tij.

Dokumenti i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me mallrat objekt prokurimi dhe që kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre. Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor sigurohet që mallrat objekt prokurimi të jenë sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar.

2.3.6Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “ofertë teknike” ne formën e tabelës , kërkesat e se ciles duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për te gjithë artikujt e listës sipas preventivit. Në plotësim të kësaj kerkese dokumenti “ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi produkteve</b>	<b>Emërtimi kompanise prodhuese.</b>	<b>Emërtimi katalogut/skedes</b>	<b>Web-site kompanisë prodhuese</b>	<b>Referenca katalogje</b>	<b>Standarti qe permbush</b>
-----------	----------------------------	--------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------	----------------------------	------------------------------

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këtë kriter është në përputhje me V.K.M nr 285 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 40 pika 6/b, ”, dhe nenin 79, të Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik

#### **2.4 Kërkesa te tjera te vecanta per kualifikim:**

- Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2020,2021** prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2020,2021 sipas kësteve pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

### *Për Procedurën e Prokurimit “Blerje materiale elektrike” për Bashkinë Selenice*

#### **Specifikimet Teknike:**

Specifikimet teknike janë përcaktuar bazuar sipas specialisteve të fushës duke iu referuar nevojave të paisjes me materiale elektrike lidhur me mbarëvajtjen e procesit të punës për institucionin, si dhe duke ju referuar specifikimeve të mëparshme për blerjen e këtyre materialeve dhe tregut sipas përcaktimeve si më poshtë

Nga eksperiencën disa vjeçare dhe konsumi i këtyre materialeve ndër vite grupi i punës ka përgatitur specifikimet teknike si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njesia	sasia	Pershkrimi
1	Kabull Ø4*6mm	ml	300	Tipi : Percjelles elektrike Paketimi : 100m Seksioni (mm <sup>2</sup> ) : 4x6 Materiali i izolimit : PVC T12/PVC TM5 ose ekuivalent
2	Kabull Ø4*4mm	ml	100	Tipi : Percjelles elektrike Paketimi : 100m Seksioni (mm <sup>2</sup> ) : 4x4

				Materiali i izolimit : PVC T12/PVC TM4 ose ekuivalent
3	Kabull Ø4*2.5mm	ml	600	Tipi : Percjelles elektrike Paketimi : 100m Seksioni (mm <sup>2</sup> ) : 4x4 Materiali i izolimit : PVC T12/PVC TM4 ose ekuivalent
4	Kabull Ø2*2.5mm	ml	1500	Tipi : Percjelles elektrike Paketimi : 100m Seksioni (mm <sup>2</sup> ) : 2x2.5 Materiali i izolimit : PVC T12/PVC TM3 ose ekuivalent
5	Kabull Ø2*1.5mm	ml	900	Tipi:Percjelles elektrike Paketimi : 100 Seksioni (mm <sup>2</sup> ) : 2x1.5 Materiali i izolimit : PVC T12/PVC TM2 ose ekuivalent
6	Tel Ø 6mm	ml	500	Tipi : Percjelles elektrike Materiali : Baker Seksioni (mm) : 6
7	Tel Ø 4mm	ml	200	Tipi : Percjelles elektrike Materiali : Baker Seksioni (mm) : 4
8	Tel Ø 2.5mm	ml	1005	Tipi : Percjelles elektrike Materiali : Baker Seksioni (mm) : 2.5
9	Tel Ø 1.5mm	ml	1600	Tipi : Percjelles elektrike Materiali : Baker Seksioni (mm) : 1.5
10	Ndricues led 100W	Cope	20	Tipi : Ndricues rruge Fuqia : 100W Lloji i llambave : led i ftoht Përfshin llambat : Po Materiali : Metal/xham Ambiente të brendshme/ të jashtme : Të jashtme Shkalla e mbrojtjes : IP65ose ekuivalent
11	Llampa led 10W	Cope	399	Llampe Led 10W6400k E27 100-240v E27-E40 Adapter ose ekuivalent
12	Llampa 12Wnatyrale	Cope	300	E27 4000k ose ekuivalent
13	Llampa led 18w	Cope	298	Llampe Led 18W E27 6.5k ose ekuivalent

14	Llampa 20w sodium	Cope	200	Llampe Natriumi Me Shkarkim Nav-T 20w ose ekuivalent
15	Llampa30w sodium	Cope	500	Llampe Natriumi Me Shkarkim Nav-T 30w ose ekuivalent
16	Llampa50w	Cope	100	Llampe Mercuri Hql 50w E27 ose ekuivalent
17	Llampa70w	Cope	100	Llampa Rx7s 70w 2000k Hdls-High Press. Sodium Tub ose ekuivalent
18	Automat 63A 4P	Cope	10	Automat 4p C63a 6ka ose ekuivalent
19	Automat 40A 4P	Cope	10	Automat 4p C40a 6ka ose ekuivalent
20	Automat 25A	Cope	20	Automat 1p C25a 6ka ose ekuivalent
21	Automat 6A 1P	Cope	20	Automat 1p C6a 6ka ose ekuivalent
22	Fotoelement	Cope	10	Sensor Muzgu 220v 1200
23	Leshues elektromanjetikme bobine 220 v ,25A	cope	12	Leshues elektromanjetikme bobine 220 v ,25A
24	Leshues elektromanjetikme bobine 220 v ,40A	cope	8	Leshues elektromanjetikme bobine 220 v ,40A
25	Leshues elektromanjetikme bobine 220 v ,63A	cope	10	Leshues elektromanjetikme bobine 220 v ,63A
26	Leshues elektromanjetikme bobine 220 v ,63A	Cope	6	Leshues elektromanjetikme bobine 220 v ,63A
27	Nastro te medha 3M elektrike	Cope	50	Nastro izolant 0.15mm x 19mm x 25m
28	Kabell shirit led me ngjyra 220 v	ml	500	Ndricimi te jetebrenda nje kabelli
<b>29</b>	<b>Kabell shirit led I bardhe 220 v</b>	<b>ml</b>	<b>500</b>	<b>Ngjyra e bardhe</b>
30	Priza 3 -she ,5ml	cope	20	Prize me kabell zgjatues 5ml 2,5
31	Portollampa	Cope	200	Portollampe porcelani E27
<b>32</b>	Pakete komanduese rele 100v- 500 v	cope	40	Releja te jete per zburime me nderprerje
33	Prozektor 50w	Cope	19	Fuqia : 50 w Fuqia në lumen : 4000 lm Materiali : Alumin / xham Ambiente të brendshme/ të jashtme : Të jashtme

				Shkalla e mbrojtjes : IP65 Jetëgjatësia : 30000 HRS
				Fuqia : 30 w Fuqia në lumen : 4000 lm Materiali : Alumin / xham Ambiente të brendshme/ të jashtme : Të jashtme Shkalla e mbrojtjes : IP65 Jetëgjatësia : 30000 HRS
34	Prozektor 30w	Cope	30	
35	Shkalle alumini	Cope	1	Me permasat 3*4 profesional
36	Nastro gome uji	Cope	30	Kundra uji 3M e madhe
				Fuqia: 250w Rryma: 1.8 A Tensioni: 220 V Frekuenca: 50 Hz Dimensionet: 160 x 135 x 95 mm Pesha: ~2.5 kg Faktori i fuqise: 0.42
37	Drozel 250w	Cope	50	
38	Klemalidhes 16	cope	300	Tip forbes
39	Priza shuk komplet	Cope	100	Prizat te jene cilesore te marakave te njohura
40	Çelsa komlet	Cope	100	Celesat te jene cilesor
41	Kuader komandimi me automat mbrojtjes	Cope	10	Hermetic me sinjalistik
42	Balandeze	Cope	2	50ml me kabull 3*2.5

**Argumentim:** Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, dhe nenit 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

*Kerkesa per dorezimin e mostrave per zerat e parashikuar ne proceduren objekt prokurimi behet duke vleresuar rendesine e tyre funksionale dhe ekonomike nga Specialisti i Fushes*



**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I:**

**Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b>	<b>NIPT –i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</b>

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]</p>

nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-.	
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
---	--

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>
<p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</p>	<p><b>Po</b> [ <input type="checkbox"/> ]</p>
<p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>	<p><b>Po</b> [ <input type="checkbox"/> ]</p>

<p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
